

Pershendetje,

Faleminderit per interesin tuaj per trajnimin "Pakete me 10 trajnime per problematika te shpeshta ne kujdes primar".

A). Prezantim i kursit me temat

Ky trajnim eshte organizuar me kerkesen e mjekeve te nje QSH shteterore te kujdesit primar bazuar ne nevojat e tyre per trajnime.

Perfshin **10 tema nga 3 ore** dhe temat jane:

1. Interpretimi i Gjak komplet, UA dhe analiza te tjera biokomike. Interpretimi ne kuader klinik.
2. Perdorimi i antibiotikeve ne kujdes primar, parimet ne baze mekanizmi dhe flore bakteriale.
3. Kujdesi ndaj plageve, Suturat- praktike qepje plagesh, profilaksia e tetanozit
4. Ekzaminimi neurologjik dhe probleme te shpeshta neurologjike,
5. Probleme te shpeshta te syve dhe ekzaminimi i syve, fundus oculi
6. Dhimbja e kokes, vleresimi i pacientit me dhimbje koke, shkaqet dhe menaxhimi
7. Lezionet kutane ne kujdes primar
8. Ekzaminim gjuri, problemet me te shpeshta te gjunjeve dhe inj intra-artikulare
9. Ekzaminimi psikiatrik, patologjite me te shpeshta psikiatrike ne primar
10. Ekzaminimi i shpatulles dhe prob te shpeshta, inj intraartikulare

Ne fund te ketij trajnimi mjeket pritet te zoterojne njohuri dhe aftesi te mira ne keto ekzaminime praktike baze: neurologjik, ekzaminim i syve dhe fundus oculi, ekzaminim gjuri, shpatulle, ekzaminim psikiatrik, ekzaminim "Head to Toe"- i plote fizik si dhe qepje te plageve.

B). Kur eshte trajnimi?

Kjo pakete trajnimi do filloje te ofrohet ne **4 Prill deri ne 16 Maj** (qe eshte provim perfundimtar) prane qendres shendetesore ABC- shih programin per detajet e datave dhe oreve perkatese.

C). Kreditet

Ky trajnim synon te pajise mjeket me njohuri te mira ne problematikat e permendura dhe do kerkoje perkushtim nga lektorët dhe nga mjeket qe do trajnohen. Trajnimi eshte ne proces akreditimi dhe presim te kete **33 kredite pasi 33 jane dhe oret efektive.**

Per shkak se trajnimi do jete praktik dhe interaktiv, numri i pjesemarrësve nuk do i kaloje 12.

Cdo Mjek qe do marre pjese perfiton kreditet nese merr pjese ne mbi **80% te temave dhe nese merr >= 60% te pikevene** provimin perfundimtar.

D). Detaje per koston dhe pagesat

Kostoja e trajnimit do jete **20.000 leke te reja ne total**, shume qe preferohet te paguhet tek receptioni i ABC qe ne fillim para se kursi te filloje por mundet dhe qe pjesa me e madhe te paguhet para se te filloje kursi qe mjeku te quhet i rregjistruar dhe pjesen qe ngelet duhet ta paguaje brenda dates 16 Maj qe eshte dhe dita e fundit e trajnimit.

E) Lektoret

Jane mjekte, pjese e stafit te QSH ABC.

F) Dokumenta te atashuar: programi i kursit

G) Rregjistrimi

Mjeket do quhen te rregjistruar kur ata te kene paraqitur nje **dokument identifikimi** dhe te kene **filluar pagesen** prane receptionit te ABC. Intersi i treguar me email nuk siguron nje vend ne kurs. Rregjistrimet mbyllen sapo numri i mjekteve te rregjistruar te arrije 12.

Ju lutem ndihuni te lirshem te na kontaktoni per cdo paqartesi te mundshme.